



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 08.05.2023)

Pikat 2, 3, 4 të rendit të ditës me objekt¹: 2. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

3. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

4. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:52 dhe mbaroi në orën 13:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Ilir Rusi

(zëvendëskryetar)

¹ Këto çështje ishin parashikuar të trajtoheshin si pike e pare, e dytë dhe e tretë sipas rendit të ditës.

2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL).*
5. *Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *{...}, {...}, {...} (të tre në sallë) dhe Mimoza Koçiu, përfaqësues nga ILD.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

2. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

3. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

4. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Ju uroj mirëseardhjen dhe javë të mbarë.

Ajo çfarë do bëja me dije, në mbledhjen e sotme kishim dhe një çështje e cila diskutohet dhe vendimmarrja përkatëse është me dyer të mbyllura, dhe kjo ishte arsyeja për të cilën në këtë kohë, prej orës 10:00 është diskutuar çështja përkatëse e cila përfundoi.

Në vijim të rendit të ditës dhe sipas njoftimeve të bëra, përveç të tjerave sot kemi diskutimet e tre procedimeve disiplinore të cilat kanë filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...}.

Sipas njoftimit të bërë dhe prezencën në sallë, përfaqësues me autorizim nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është znj. {...} dhe z. {...}, me detyrë inspektorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilët së bashku do të përfaqësojnë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor nr.3/2022 në ngarkim të magjistratit z. {...}, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, që do të zhvillohet në Këshillin e Lartë Gjyqësor në seancën e datës 8.05.2023, ora 11:00.

Ndërkohë, po me autorizim, jemi bërë me dije që prezent në sallë është edhe përfaqësuesi tjetër i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. {...}, me detyrë inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që do të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor 1 dh 2 të vitit 2023, në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë magjistrat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, që do të zhvillohet në

Këshillin e Lartë Gjyqësor, për të cilën për secilin procedim ka autorizime të veçanta, edhe për procedimin 1/2023 dhe për procedimin 2/2023.

Në vijim të procesit, ju bëj me dije që prej datës 5 maj të vitit 2023, sipas aktit të lëshuar nga Instituti Shëndetësor “Spitali Rajonal Shkodër”, me nr. regjistri 134 është raport mjekësor për sëmundje që trajtohen nga komisioni mjekësor dhe mbulohen nga sigurimet shoqërore. Është paraqitur një raport i cili fillon prej datës 05.05.2023 deri më datë 04.06.2023 në lidhje me zotin {...}.

Ndërkohë, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, sikpas detyrave të lëna edhe në mbledhjen e mëparshme është bërë njoftimi përkatës për zotin {...} në lidhje me procedimet disiplinore të filluara rishtazi për të, gjithashtu në pjesën e fundit të shkresës/korrespondencës përkatëse zyrtare është përcaktuar që: “Në kushtet e mësipërme, ju bëjmë me dije se në seancën e ardhshme, nëse jeni në pamundësi për t’u paraqitur personalisht, të zgjidhni një përfaqësues ligjor për të mbrojtur të drejtat tuaja.”

Ky është njoftimi që është bërë nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor për z. {...}. Në lidhje me të është paraqitur raporti mjekësor i cili përsëri është për paaftësi të përkohshme 1-mujore, ka filluar në datën 05.05 dhe përfundon në datë 04.06.2023.

Ajo çfarë duhet sqaruar për publikun është që meqenëse kemi të bëjmë me tre procedime disiplinore dhe i kemi lënë sipas rendit të ditës në mënyrë të njëpasnjëshme, prandaj edhe fjala për ekonomi gjyqësore po e përdorim në mënyrë kumulative për procedimet përkatëse dhe është i njëjti fakt si njoftimi i bërë procedimet përkatëse por njëkohësisht edhe për paraqitjen e raportit mjekësor.

Për më tej fjala për përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me vijimet e mëtejshme të këtij procedimi disiplinor, saktësisht për seancën dëgjimore përkatëse.

Ndërkohë që administrata po ju vë në dispozicion raportin mjekësor përkatës, në dy kopje, një për z. {...} dhe një për znj. Pepi dhe z. Nasufi për shkak të përfaqësimeve në procedime të ndara për të.

{...}: Faleminderit!

Atëherë, për shkak, sepse magjistrati subjekt procedimi disiplinor nuk është paraqitur përsëri në seancë, arsytet siç ka ndodhur edhe në seancat paraardhëse, kanë të bëjnë me paaftësinë e përkohshme lidhur me... të cilat i ka vërtetuar me raportet mjekësore të lëshuar nga Komisioni Mjekoligjor.

Atëherë, në lidhje me zhvillimin e seancës dhe vijimin, i qëndrojmë kërkesës të bërë në seancën paraardhëse të datës 05.04.2023, për caktimin kryesisht të një përfaqësuesi ligjor nga Këshilli, për shkaqet të cilat ua kemi relatuar dhe në seancën paraardhëse, sepse realisht pamundësia objektive për paraqitjen e magjistratit në seancë dëgjimore është objektive. Sepse, referuar edhe legjislacionit “Për sigurimet shoqërore”, magjistrati subjekt procedimi disiplinor mund të vazhdojë me këto raporte deri në 1 vit, pasi janë raporte që lëshohen nga Komisioni Mjekoligjor (KML). Dhe në përfundim të njëvjeçarit është po ky komision i cili referon për më tej në Komisionin Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), i cili më pas do konkludojë nëse ky person është në kushtet e aftësisë për punë apo jo? Në varësi të faktit dhe pamundësisë në lidhje me aftësitë për punë, atëherë ai mund të referohet për pension invaliditeti të pjesshëm ose të plotë.

Ilir Rusi: Faleminderit z. Nasufi!

Po, z. {...}!

{...}: Faleminderit!

I nderuar z. Nënkryetar!

Të nderuar anëtarë KLGJ-së!

Në emër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me dy procedimet nr. 1 dhe 2 të vitit 2023, më lejoni edhe në vijimësi edhe të fjalës që mbajti z. Eugen, përfaqësuesi tjetër i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që qartazi rezulton që magjistrati {...} nuk ka vullnet për të zgjedhur përfaqësues, sepse ju vetë e deklaruat që i keni dhënë mundësinë që ai të zgjedhë përfaqësues, pra plotësohet paragrafi i dytë i nenit 36, pika 3, pjesa e dytë, që duhet të zgjedhë një përfaqësues që të mbrojë interesat e tij.

Së dyti, procesi i rregullt ligjor është proces kushtetues që zë vend në nenin 42 dhe ne duhet ta respektojmë të gjithë pa diskutim, por ky proces nuk ka vetëm privilegje por ka edhe detyrime. Që do të thotë, nëse je në pamundësi objektive/subjektive, ose cakton përfaqësues ose kur je në pamundësi objektive, sikurse Kodi i Procedurës Administrative njeh, të caktohet një avokat kryesisht.

Ky Këshill i nderuar i ka dhënë mundësinë jo një herë, por mbi 5 herë, që ai të paraqitet personalisht, që të zgjedhë një mbrojtës, pra i keni garantuar katërçipërisht të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Nuk e ka shfrytëzuar, është disponibiliteti i tij. Por ky proces është proces publik, i shërben interesit publik dhe askush s'mund ta mbaj peng. Ndaj dhe, në zbatim të urdhërimeve të nenit 36, pika 3, germa "c" është e nevojshme të caktohet një avokat kryesisht që ai të mbrojë interesat e tij, sikurse ndodh në proceset penale, për analogji.

Caktimi i një avokati kryesisht nuk do të thotë që ai nuk do mbrohet. Caktimi i një avokati kryesisht do të thotë që çështja e tij të shqyrtohet me një gjykim të drejtë, publik, brenda një afati të arsyeshëm, duke i dhënë mundësinë që të ketë një mbrojtës. Dhe mos të harrojmë, pika 36/5 i jep mundësinë që në çdo kohë të paraqitet dhe të caktojë avokatin e tij. Le ta vijojmë ashtu sikurse ligjvënësi ka parashikuar, që të caktojë një mbrojtës kryesisht sot, nga ky Këshill i nderuar. Nëse ai ka vullnet më pas që ta ndryshojë mbrojtësin që i cakton Këshilli, le të paraqitet në cdo kohë, ta revokojë, me një akt përfaqësimi, personalisht, i përfaqësuar, të vazhdojë shqyrtimin.

Pra ne i qëndrojmë qëndrimin që sot të merret një vendim për caktimin e një mbrojtësi kryesisht dhe t'i jepet mundësia mbrojtësit që të vijë të njihet me aktet.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. {...}!

Po, z. Toro!

Alban Toro: ... çfarë nënkuptoni, sepse ai aktualisht pretendon që ka një shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen, ndërkohë që ligji thotë që në rastet kur kërkohet të

procedohet sipas nenit 36, pika 3, kërkohet ekzistenca dhe verifikimi i kushteve objektive. Me këtë të fundit çfarë nënkuptoni?

{...}: Ligjvënësi ka shprehur shumë qartë. Nuk thotë për arsye subjektive duhet të vazhdojë gjykimi. Akoma më tepër, thotë edhe për arsye objektive kur ai me vullnetin e tij, po themi ndodhet jashtë shtetit; është i sëmurë. Nuk po e mohojmë, nuk po vëmë në diskutim raportin mjekësor. Po shtrojmë çështjen që meqenëse ai sot nuk paraqitet, dikush duhet ta përfaqësojë dhe ta mbrojë. Cili? Një avokat të tij nuk e ka zgjedhur. Ta mbrojë një avokat i caktuar kryesisht nga organi procedues. Pra nuk po vëmë në diskutim që pamundësia e tij është subjektive. Është objektive. Por pikërisht se është objektive dhe e përsëritur, dhe për të mos mbartur peng procesin publik që po zhvillojmë, do t'i caktohet një avokat, siç e parashikon ligjvënësi. Kaq e thjeshtë. Ne nuk mund të interpretojmë ndryshe sepse është dispozita më pas nëse ai dëshiron të zgjedhë avokatin e tij, vjen në cdo kohë (neni 36, pikë 5) dhe e zëvendëson.

Ilir Rusi: Faleminderit z. {...}!

Po znj. Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Kam një pyetje për përfaqësuesin.

Pse i referoheni si bazë ligjore Kodit të Procedurave Administrative?

{...}: (nuk dëgjohej fjala hyrëse) ... ne nuk jemi gjykatë e mirëfilltë.

Jemi të dy organe administrative. Sigurisht bazohem (e theksova) nga parimi kushtetues, neni 42. Nuk e mohoj. I kemi dhënë shansin disa herë dhe pikërisht po i japim mundësinë që të përfaqësohet, të mbrohet. S'po i cenojmë të drejtën.

Brikena Ukperaj: Si e interpretoni ju nenin 116, pika 1, të ligjit "Për statusin" që bën fjalë për magjistratin ose përfaqësuesin kur nuk paraqitet në seancën dëgjimore në Këshill, i cili drejtpërdrejt thërret për zbatim dispozitat e Kodi të Procedurës Administrative?

{...}: Në procesin administrativ ne nuk jemi prokurori dhe s'jemi as gjykatë. Sigurisht kemi kompetenca të tilla investiguese dhe vendimmarrëse të ngjashme dhe akti kryesor është Kodi i Procedurës Administrative, “lex specialis derogat legi generali”, por jo kur bëhet fjalë për një akt më të madh siç është Kodi i Procedurës Administrative dhe këtu ka dhjetëra vendime të Gjykatës Kushtetuese që Kodi i Procedurës Administrative prevalon.

Ilir Rusi: Faleminderit z. {...}!

Ka diskutime apo pyetje të tjera për përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për sa u parashtrua nga ata?

Po, z. Kurushi!

Klodian Kurushi: (nuk dëgjohej fjala hyrëse) ... e dilemës se cilën dispozitë në këtë rast duhet të zbatojmë. Nëse e kemi parasysh dispozitat e parashikuara nga ligji “Për statusin e gjyqtarëve”, neni 116-117 i Kodit të Procedurës (korrigjohet), i referohet nenit 116 të ligjit “Për statusin”, kjo dispozitë neve na lejon që në rast të mungesës së personit i cili është në procedim disiplinor këtu përpara Këshillit, pra në rast të mungesës, deklarohet mungesa dhe ligji na lejon që ne të zbatojmë dispozitat e K.Pr.Penale, për aq sa gjen zbatim. Jemi të qartë me këtë pjesën?

Ju tani thatë në shpjegimet tuaja – është thjesht për të marrë një opinion që do të na ndihmojë edhe ne në procesin e vendimmarrjes – ju thatë që dakord “lex specialis derogat legi generalis”, por ne nuk e shmangim dot dhe me të vërtetë nuk e shmangim dot Kodin e Procedurave Administrative, jemi edhe në një proces administrativ. Por doja të bëja një pyetje specifike për ju. Kur mund të zbatohet kjo dispozitë? Pra kur mund ta marrim ne në konsideratë zbatimin e nenit 116, paragrafi i parë i ligjit “Për statusin”, pra që të zbatojmë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale? Cili mund të jetë një rast për shembull? Nëse s’është ky rast? Jam i qartë me pyetjen?

{...}: Mendoj që Kodi i Procedurës Penale, të drejtat dhe liritë (po e bëj për krahasim se s'është e njëjta gjë, se s'është i pandehur këtu) e të pandehurit i ka shumë më të qarta, shumë më të strukturuar, në kuadrin e hetimit dhe gjykimit. Pa diskutim, për analogji, ato të drejta që lidhen me njoftimin, dëgjimin, marrjen mendësinë e mbrojtjes, caktimin e mbrojtësit, pjesëmarrjen, pa diskutim vlejné, vlejné sepse derivojnë nga Kushtetuta. Unë jo më kot përmenda normën më të lartë. Nuk kemi pse të përmendim as Kodin e Procedurës Penale, kur unë po theksoj atë kushtetues. Por edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka theksuar në dhjetëra vendime (vetëm më lejoni t'jua sjellë herës tjetër), që edhe e drejta e mbrojtjes nuk mund të bëhet e tillë që të abuzohet dhe të mbahet peng një proces gjyqësor... S'është absolute dhe s'mund të mbahet peng një proces gjyqësor civil që lidhet me interesin publik. Kjo është aksiomë. Por e rëndësishme është që të pandehurit t'i garantohet mbrojtja efektive. Atë po kërkojmë. Nuk po themi një mbrojtës të caktohet sot dhe të mbarojmë sot shqyrtimin. Një mbrojtës që të vijë këtu, të njihet me dosjen, t'i jepet kohë e mjaftueshme të mbrojë interesat e tij dhe derisa s'është mbyllur shqyrtimi gjyqësor, ne e dimë shumë që janë dhjetëra vendime unifikuese që mbrojtësi i zgjedhur nga vetë personi (i pandehuri), në rastin konkret magjistrati, prevalon mbi atë kryesisht. Ta revokojë, ta zëvendësojë, të vijë, të paraqitet. Këto janë garancitë që ofrojnë të dy proceset.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. {...}!

Ka pyetje të tjera apo çështje të parashtruara nga anëtarët?

Pas këtyre diskutimeve, keni për të shtuar diçka tjetër ju si përfaqësues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë?

Po z. Nasufi, fjala për ju!

{...}: Në rastin e parashtruar, neni 116 i ligjit 96/2016 nuk parashikon rastet e mungesës së magjistratit për arsye objektive, por rastet e mungesës për arsye subjektive sepse përcakton rastet e deklarimit në mungesë. Nga ana e Këshillit, në rastin konkret nuk është marrë vendim për deklarimin në mungesë, rastin që magjistrati nuk është paraqitur

pa shkaqe të arsyeshme, megjithëse ka pasur dijeni për ditën dhe orën e gjyqimit. Ndërkohë që neni 141 i ligjit 96/2016, në pikën 2, parashikon: 2. Kur magjistrati njoftohet se ndaj tij ka filluar procedim disiplinor, duhet që t'i bëhen të ditura të drejtat: a) [...]; dh) për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative; [...].” (ripërsëritet neni “141/2/dh”)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim, ka ndonjë pyetje nga anëtarët për sa u parashtrua?

(Nuk ka pyetje nga anëtarët.)

Ju tre përfaqësuesit keni diçka për të thënë deri në këtë moment?

(Nuk ka diskutime të tjera.)

Atëherë, do t'ju ftoja që të largoheshit me qëllim që Këshilli të vazhdojë me diskutimet në lidhje me një vendimmarrje për sa u parashtrua nga ju dhe për vijimin e mëtejshëm të seancave dëgjimore.

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë Drejtësisë. Mbledhja dhe diskutimi vijon vetëm në prezencën e anëtarëve të Këshillit. Më tej, futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së për t'u njohur me vendimmarrjen e Këshillit. Gjithashtu mundësohet edhe lidhja për të tretët nëpërmjet platformës.)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të këtyre seancave dëgjimore në lidhje me magjistratin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi kërkesën e përfaqësuesve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me caktimin e një përfaqësuesi ligjor kryesisht magjistratit z. {...}, vendosi: Rrëzimin e kërkesës, pasi gjykoi që nuk jemi në kushtet e përcaktimeve të nenit 116 të ligjit “Për statusin”.

Në vijim të seancave dëgjimore, të tre seancat dëgjimore, përkatësisht për procedimin disiplinor nr. 3/2022, nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023, vendosi që këto seanca dëgjimore, meqenëse kanë të bëjnë me të njëjtin magjistrat, të jenë në të njëjtën ditë, në datën 06.06.2023, ora 11:00, ditë e martë, në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të cilën do të njoftohet edhe z. {...}.

Gjithashtu, në përmbushjen e detyrave nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u vendos:

Fillimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore, për shkak të ushtrimit të funksionit nga magjistrati z. {...}, në lidhje me paraqitjen nga ana e tij në mënyrë të pandërprerë të raporteve mjekësore, të cilat e bëjnë të justifikuar mosparaqitjen e tij në punë; dhe për këtë arsye, ngarkon Komisionin e Zhvillimit të Karrierës për vijimin e këtyre procedurave në lidhje me verifikimin e kësaj mundësie fizike apo mendore për shkak të këtyre raporteve mjekësore të paraqitura, të cilat janë të lëshuara deri më tani nga organet përkatëse.

Ju faleminderit! Këtu e deklarojmë të mbyllur vijimin e seancave dëgjimore.

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.)

* * *

(Pikat 2, 3, 4 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 08.05.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës së komanduar {...} për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:52 dhe mbaroi në orën 13:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL).*
5. *Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtim i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares së komanduar {...} për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 (relatore *znj. Brikena Ukperaj*).

Ilir Rusi: Atëherë, vijojmë me pikën 5 të rendit të ditës, për shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares së komanduar {...} për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Për më tej fjalën ia jap relatores *znj. Ukperaj*.

Brikena Ukperaj: Faleminderit z. Rusi!

Gjyqtarja {...}, aktualisht e komanduar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë vitit 2013-2016, periudhë e cila përkon me periudhën e procesit të rivlerësimit kalimtar, ka ushtruar detyrën e inspektore në Inspektoratin e ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë, e ngarkuar për të ushtruar këtë detyrë pranë seksionit të inspektimit.

Projektraporti i vlerësimit është përpiluar në zbatim të dispozitave 68, 89 e vijues, në nenin 171, pika 5, të Ligjit “Për statusin”, si dhe të gjithë paketës së akteve nënligjore të miratuara së fundmi nga KLGJ për vlerësimin e gjyqtarëve të komanduar në Këshill, ku në dispozitat tranzitore të tyre janë përcaktuar konkretisht burimet e vlerësimit dhe e gjithë procedura e vlerësimit që ndiqet me rastin e gradimit të këtyre gjyqtarëve.

Projektraporti i vlerësimit, bashkë me aktet përkatëse (shtojca që shoqëron projektraportin e vlerësimit), i janë njoftuar gjyqtarës së komanduar në adresën e saj elektronike. Ajo ka marrë dijeni dhe është shprehur dakord me konkluzionet e relatorit. Nuk ka kërkuar të dëgjohet, nuk ka paraqitur kundërshtime dhe nuk ka bërë kërkesë për marrjen e provave të reja.

Në pjesën e parë të projektraportit përshkruhet procedura e ndjekur. Konkretisht gjyqtarja e komanduar në periudhën tetor 2013-nëntor 2015 ka ushtruar detyrën e inspektore (2 vite e 1 muaj). Është shkëputur pastaj për leje barrë lindjeje në periudhën dhjetor 2015-gusht 2016 dhe është rikthyer në të njëjtën detyrë në muajin gusht 2016 deri në përfundim të vitit 2016 (për ta konsideruar të gjithë periudhën e vlerësimit). Gjatë gjithë kësaj periudhe, efektivisht detyrën e inspektore, rezulton që ta ketë ushtruar për një kohëzgjatje prej rreth 2 vite e 4 muaj.

Lidhur me burimet e vlerësimit. Burimet e vlerësimit janë evidentuar në pjesën e dytë të projektraportit të vlerësimit. Vlen të theksohet se në këtë rast, si raport analitik vlen raporti i analizimit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit i cili është përgatitur nga KLGJ në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në këtë raport përshkruhen të gjitha të dhënat e burimeve të rivlerësimit në kushtet kur në gradim nuk marrim burime të tjera vlerësimi dhe analizohen edhe gjetjet që kanë rezultuar nga vëzhgimi i tyre.

Këto burime vlerësimi përbëhen nga: Formulari i vetëvlerësimit profesional; Të dhënat e dosjes personale të gjyqtarës; Të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit, nga ku rezulton që ajo ka trajtuar në total 741 praktika/raporte dhe numri i raporteve të mbartura për vitin pasardhës është 0 (zero). Veç këtyre ka angazhime të gjyqtarës edhe në detyra të tjera: ka dhënë kontribut në përgatitjen e 6 (gjashtë) inspektimeve tematike të kryera nga ish-KLD; ka përfaqësuar ish-KLD-në në 10 (dhjetë) çështje gjyqësore; ka

marrë pjesë në grupin e punës për hartimin e Skemës së Vlerësimit të punës së inspektorit; ka marrë pjesë në takimet e Këshillit Drejtues për zbatimin e projektit “Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë SEJ”; Burim vlerësimi përbëjnë edhe dokumentet ligjore të çështjeve të përzgjedhura me short në procesin e rivlerësimit kalimtar (5 dokumente). Janë të gjitha relacione për verifikim ankese mbi bazën e një burimi që mund të jetë ankesa ose edhe burim i hapur; ka edhe verifikime të filluara kryesisht nga ish-Inspektorati, ku është caktuar inspektore znj. {...}; Burim vlerësimi përbëjnë edhe dokumentet e përzgjedhura prej saj. Të tre dokumentet janë relacione, edhe ato për verifikim ankesash.

Në dosjen e dërguar nga organet e rivlerësimit kalimtar nuk rezultojnë të jenë administruar akte apo dokumente për shkak të ankesave apo kryesisht të bëra ndaj gjyqtares, të cilat mund të bënin të dhëna burimore për vlerësimin etik dhe profesional.

Referuar burimeve arkivore që ka pasur KLD dhe KLGJ, bazuar në raportin e analizimit të aftësive profesionale të saj, rezulton se sipas të dhënave nga regjistri i ankesave gjatë periudhës trevjeçare, për inspektoren {...} nuk ka asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së. Referuar të dhënave për procedime disiplinore nuk ka pasur asnjë ankesë të regjistruar nga Ministria e Drejtësisë në atë kohë si autoriteti kompetent, për procedim disiplinor apo të jetë propozuar në ish-KLD ndonjë masë tjetër për procedim disiplinor.

Sa më sipër, për periudhën e vlerësimit 2013- 2016, referuar të dhënave të burimeve arkivore të KLD/KLGJ, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të etikës apo që mund të përdoren për vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtares të komanduar në detyrën e inspektore.

Burim vlerësimi përbëjnë të gjitha të dhënat për pjesëmarrje në aktivitete trajnuese të gjyqtares së komanduar, brenda vendit si dhe jashtë tij.

Gjithashtu, burim vlerësimi i rëndësishëm është edhe vlerësimi etik dhe profesional që i është bërë gjyqtares në detyrën e inspektore me vendimin e KLD-së me nr. 112, datë 04.11.2016 (pra ajo ka një vlerësim për periudhën e vlerësimit 2013–2014, i cili në metodologji është referuar si një nga burimet e tjera të vlerësimit.

Ndërkohë, burim vlerësimi është edhe vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me të gjitha konkluzionet në të tria shtyllat: verifikimi i pasurisë, verifikimi i figurës si dhe verifikimi i aftësive profesionale.

Po vazhdoj me analizën e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi.

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit në ish/Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të dokumentave të hartuar, vlerësuesi përqendrohet në të dhënat që përfshihen në dosjen me aktet e vlerësimit profesional të gjyqtarit, të dërguara nga organet e rivlerësimit kalimtar. Vlerësuesi çmon aftësinë hulumtuese, interpretuese dhe logjikën e gjyqtarit në lidhje me hartimin e dokumentave ligjorë të tillë si: drafte aktesh nënligjore, projektvendime/vendime, opinione ligjore, analiza, materiale studimore krahasimore mbi kuadrin ligjor dhe jurisprudencial vendas dhe të huaj, projektraporte, raporte dhe materiale të tjera të lidhura me çështje specifike, etj. Aftësia profesionale e gjyqtarit të komanduar pikëzohet, sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor.

Duke filluar me aspektin e parë të “Njohurive ligjore” – Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, në projektraport, pasi janë evidentuar të gjitha gjetjet që Këshilli ka bërë në raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit (znj. {...}), janë analizuar gjetjet që i përkasin aktit të vlerësimit të aftësive profesionale të miratuar me vendimin e KLD nr. 112, datë 04.11.2016, si dhe janë analizuar të gjitha dokumentet ligjore, pjesë e dosjes së vlerësimit, nga ana ime si relatores është konstatuar se gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektore pranë Inspektoratit të ish-KLD ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë, konciz, të saktë dhe të plotë të fakteve të çështjes/ankesës objekt shqyrtimi, paraqitjen e tyre në mënyrë të integruar me faktet që rezultojnë nga dokumentacioni dhe informacioni i marrë për efekte të verifikimit të ankesës, pasqyrimin e veprimeve procedurale të kryera gjatë procedurës së verifikimit, duke integruar në përmbajtje të fakteve dhe pjesë të dokumenteve apo informacioneve me shkrim të marra (deklarimet e gjyqtarit subjekt verifikimi, pjesë nga vendimet

gjqësore të shqyrtuara, etj.). Sa i përket identifikimit të normës/normave të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim, në të gjitha dokumentet burim vlerësimi referohen dispozita të ligjit dhe akteve nënligjore të ish-KLD-së lidhur me procedurën e verifikimit/inspektimit dhe baza ligjore në mbështetje të mendimit të inspektorit mbi mënyrën e përfundimit të trajtimit të ankesës. Po ashtu, identifikohen dispozita të ligjit procedural penal ose civil, dispozita të ligjeve organike, të Kodit të Etikës Gjyqësore etj., të cilat mbështesin argumentimin ligjor të inspektores lidhur me rastin. Përbën vlerë të shtuar identifikimi dhe referimi i saj, në mbështetje të arsytimit ligjor, i praktikës së GJEDNJ (kryesisht me çështjet e arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe të procesit të rregullt ligjor), vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të cilat aplikohen në drejtim të standardeve objekt vlerësimi për të gjitha rastet e trajtuara.

Për këtë arsye, lidhur me treguesin e parë kam propozuar shkallë shumë të lartë aftësie, pikëzimi me 25 pikë.

Lidhur me aftësinë për të interpretuar ligjin, duke u bazuar në të njëjtat burime vlerësimi pra konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar; aktet e vlerësimit të miratuar nga ish-Këshilli për inspektoren për periudhën 05.07.2013 – 31.12.2014; dokumentet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, kam vlerësuar se gjyqtarja e komanduar {...}, gjatë ushtrimit të detyrës së inspektores, ka shfaqur aftësi të larta në drejtim të interpretimit të ligjit të zbatueshëm, në mbështetje të opinionit të saj në lidhje me trajtimin dhe propozimin për zgjidhjen e çështjeve konkrete. Ajo i kushton rëndësinë e duhur, në raport me kompleksitetin e faktit konkret, interpretimit abstrakt të ligjit të zbatueshëm dhe dhënies së arsyeve dhe argumenteve mbi mënyrën e zbatimit të tij mbi faktet e çështjes. Po ashtu, rezulton kujdesi i saj për të zbatuar por edhe marrë në analizë parimet e përgjithshme të së drejtës (parimi i ligjshmërisë dhe parimi i procesit të rregullt ligjor), si dhe për të pasuruar interpretimin e saj lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjesh, me qëndrime të praktikës gjyqësore.

Vlen të theksohet se lidhur me aftësinë për të interpretuar ligjin, referuar legjislacionit në fuqi në kohën kur ajo ka ushtruar detyrën e inspektores dhe konkretisht pikën 3, shkronja “f” të nenit 31 të vendimit të ish-KLD-së “Për organizimin dhe

funksionimin e Inspektoratit të KLD-së”, ka qenë detyrë funksionale e saj jo vetëm trajtimi i ankesës por edhe dhënia e mendimit konkret mbi ekzistencën ose jo të një shkeljeje disiplinore duke interpretuar ligjin. Konkretisht dispozitat parashikojnë që raporti i inspektimit duhet të përmbante ndër të tjera edhe konkluzione rreth efektivitetit të shërbimit gjyqësor të ofruar nga gjyqtari subjekt inspektimi. Kur ishte rasti, vërejtje dhe rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së gjyqtarit, apo përshkrimin e veprimtarive të gjyqtarit, ku konstatoheshin shkelje të ligjit që konsideroheshin si shkelje disipline.

Në dokumentet e hartuara nga inspektorja në kuadër të veprimtarisë profesionale të tij, në rastet e verifikimit të ankesave apo inspektimit, përveç përshkrimit dhe analizës së fakteve dhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm, ishte e detyrueshme që të përmbaheshin edhe argumente mbi interpretimin dhe zbatimin e tij mbi rastin konkret. Interpretimi i ligjit të zbatueshëm në funksion të mbështetjes së analizës së rastit dhe rekomandimeve mbi mënyrën e përfundimit të tij, paraqiste rëndësi me qëllim përmbushjen në mënyrë cilësore të funksionit të inspektorit në lidhje me trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes konkrete, që nga procesi i vlerësimit ka rezultuar i një niveli shumë të lartë.

Lidhur me treguesin tjetër, “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria”, nga tërësia e burimeve të vlerësimit, ka rezultuar se gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektorese ka treguar kujdes të posaçëm për pasqyrimin e qartë, konciz dhe të saktë të ankesës apo çështjes objekt verifikimi, të fakteve të çështjes, ecures procedurale të trajtimit të rastit, evidentimit të dokumenteve dhe informacioneve të marra në kuadër të verifikimit, përcaktimit të çështjeve që përbëjnë objektin e verifikimit dhe vlerësimit, arsyetimin ligjor dhe paraqitjen e konkluzionet të saj në formën e sugjerimit lidhur me trajtimin e rastit. E njëjta shkallë kujdesi evidentohet në drejtim të kuptueshmërisë të mendimit të shprehur lidhur me zgjidhjen e çështjes apo evidentimin e çështjeve për diskutim më qëllim trajtimin e rastit. Për këtë kriter propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi 15 pikë.

Lidhur me “Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të dokumenteve ligjore”, përgjithësisht të gjitha dokumentet e analizuara ndjekin të njëjtën strukturë.

Pjesa hyrëse e relacionit përmban subjektet/organet që urdhërojnë, miratojnë apo kryejnë inspektimin. Ka pjesën përshkruese – arsyetuese ku evidentohet përmbajtja e ankesës, më tej faktet e çështjes, dhe në fund analiza e saj.

Në të gjitha dokumentet ligjore evidentohet një strukturë e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentit, pavarësisht përmbajtjes që ka secila ndarje. Në të gjitha dokumentet ndjekin një strukturë të njëjtë, të organizuar mbi bazën e një ecurie logjike të rrjedhshmërisë së mendimit juridik, e cila orienton saktë lexuesin. Shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik”, në tërësi, në dokumentet ligjore të analizuar, analiza ligjore dhe shkalla e argumentimit logjik, pavarësisht se në masë të ndryshme kushtëzuar nga natyra komplekse ose jo e çështjes, rezultojnë të lartë. Evidentohet qartë aftësia e gjyqtarëve të komanduar për të ekstraktuar dhe analizuar aspektet thelbësore në lidhje me shkaqet e ngritura në ankesë/çështjen e marrë në shqyrtim, dhënia e argumenteve të plotë dhe koncize lidhur me mënyrën e zbatimit të ligjit mbi këto fakte. Po ashtu, rezultojnë aftësia e saj për të evidentuar në raste specifike çështjet ligjore që duhet të vlerësohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe në çdo rast çështjet e ngritura janë shoqëruar dhe me një analizë ligjore të saj lidhur me to. Analiza dhe argumentimi logjik ndjek kryesisht rregullin: fakt–çështje–normë–interpretim–konkluzion dhe argumentimi logjik ka vijueshmëri duke u evidentuar veçanërisht interpretimin individual të ligjit nga ana e saj, si dhe aftësinë e saj për të evidentuar dhe ngritur çështje për të cilat duhet të behën objekt diskutimi nga Këshilli, me qëllim aplikimin e njëjtë në raste të ngjashme. Ka qenë një rast specifik ku nga vetë inspektorja është propozuar që informacionet periodike të kryetarëve të gjykatave që vinin për dorëzimet e dosjeve jashtë afatit të gjyqtarëve, nuk përbënin shkak të mjaftueshëm për fillimin e një procedimi disiplinor nëse nuk kishte ankesë nga ana e palës konkrete. Arsyetimi i dokumenteve ligjore në tërësinë e tyre është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha shkaqeve të ngritura në ankesë apo në çështjen objekt verifikimi/inspektimi, duke përmbushur standardet e një dokumenti ligjor të plotë, të qartë dhe të argumentuar ligjërisht. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së gjyqtarëve të komanduar, aftësia e saj për këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e

lartë”. Në pikëzimin e këtij treguesi, konsiderohen edhe të dhënat lidhur me mungesën e rasteve kur dokumentet ligjore të hartuara prej saj të jenë kthyer nga organet kontrolluese (Kryeinspektori) për plotësim apo korrigjim në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik në dokumentet ligjore burim vlerësimi.

Për këtë arsye, edhe për këtë tregues është propozuar shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi 25 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e “Aftësive profesionale”, propozohet nivel i “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Për sa i përket “Aftësisë organizative”, lidhur me “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, në fakt për të gjithë grupkriterin e këtij treguesi janë të njëjtat të dhëna burimore të cilat janë: të dhënat statistikore të pozicionit të punës si inspektor; konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; aktet e vlerësimit të aftësive të miratuar nga ish–Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për periudhën e vlerësimit 2013–2014; si dhe dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar. Nga analiza e të gjitha të dhënave statistikore, rezulton se për periudhën 08.10.2013–10.11.2015 dhe 01.08.2016–08.10.2016, me një kohëzgjatje pune prej afërisht 27 muaj, ka përfunduar 573 çështje duke hartuar raportet përkatëse. Në fakt ka pasur një vetë raportim nga gjyqtarja për 741 praktika, por referuar të dhënave statistikore të cilat janë administruar për efekt të procedurave të shortit që kanë ndjekur organet e rivlerësimit, në fakt janë evidentuar vetëm 573 çështje. Janë çështje që bëjnë fjalë vetëm me trajtimet e raporteve në lidhje me inspektimet.

Ndërkohë, sa i përket standardit sasior të punës së gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, referuar sistemit të vlerësimit të kohës, konkretisht vendimit 36, datë 29.04.2015 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, në nenin 6, pika 2, rezulton se *b. inspektori i Seksionit të Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave duhet të hartonte jo më pak se 150 ankesa në vit. Nëse volumi i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në Inspektorat nuk e lejonte përmbushjen e këtij standardi, inspektori duhet të realizonte volumin e punës të përshtatshëm në raport me numrin e inspektorëve të këtij*

seksioni. c. në vlerësimin e standardit sasior merrej në konsideratë deri në masën 30% edhe volumi i detyrave të tjera të përmbushura nga inspektori, siç mund të ishte: i. pjesëmarrja në grupe pune; ii. përfaqësime gjyqësore; etj.

Duke iu referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013–2016, rezulton se znj. {...}, për periudhën kohore afërisht 27 muaj që ka ushtruar detyrën, ka përfunduar 573 ankesa. Në këtë mënyrë e ka tejkaluar standardin sasior për tre vjet me 236 çështje ose me 70% të standardit sasior që ka qenë në fuqi.

Po ashtu, rezulton angazhimi i saj në detyra të tjera të tilla si: inspektimi në gjykata apo pjesëmarrja në grupin e punës për hartimin e Skemës së Vlerësimit të inspektorëve, të cilat në vlerësimin tërësor përfshihen në volumin e punës së inspektorit. Nga ana tjetër, për dy vite (2013–2014), Kryeinspektori, aftësinë e saj në drejtim të përballimit të ngarkesës në punë, e ka vlerësuar shumë mirë, ka qenë niveli më i lartë i vlerësimit.

Prandaj, duke iu referuar të gjitha të dhënave që referojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se në periudhën e vlerësimit ka trajtuar 573 ankesa, duke tejkaluar standardin me 70%, si dhe ka tejkaluar edhe 30% e angazhuar në fakt në detyra të tjera, për arsye se gjatë kësaj periudhe Inspektorati ka punuar pothuaj me 40% mungesë të stafit të vetë të inspektorëve. Për pasojë, në lidhje me treguesin “Aftësia për të realizuar volumin normal të punës”, aftësia e saj duhet të pikëzohet maksimalisht, dhe e kam propozuar me 25 pikë.

Për sa i përket “Aftësisë për të respektuar afatet”, gjithmonë referuar kuadrit ligjor të zbatueshëm, afatet e vendosura për trajtimin e praktikave nga inspektorët ndaheshin në tre kategori. Ishte afati urgjent brenda 48 orëve i cili caktohej gjithmonë nga ana e Kryeinspektorit; ishte afati prioritar, i cili caktohej edhe ai nga ana e Kryeinspektorit në mënyrë të shprehur për t’i dhënë ankesës një trajtim përparësor krahasuar me detyrat e tjera të inspektorit, si dhe ka qenë edhe afati normal i cili ka qenë jo më vonë se 30 ditë; të parashikuara këto afate në aktin nënligjor të kohës. Nga ana tjetër, në këtë akt nënligjor parashikohej që për efekt të standardit kohor të punës, numri i rasteve për të cilat raporti duhet të hartohet jashtë afateve nuk mund të kalojë 40% të numrit të përgjithshëm të raporteve të hartuara nga inspektori gjatë vitit kalendarik. Në vlerësimin e këtij

standardi minimal mbahet në konsideratë volumi i përgjithshëm i punës së inspektorit nga pikëpamja sasiore, si dhe kushtet e vështira të punës.

Në projektraport janë pasqyruar të gjitha relacionet që kanë qenë dokumente ligjore të dosjes si dhe afati i trajtimit të tyre.

Në 5 çështjet e analizuara, materialet janë trajtuar dhe përfunduar nga gjyqtarja në cilësinë e inspektore brenda afateve të zbatueshme, sipas aktit nënligjor, pra për një kohë të barabartë ose më të shkurtër sesa afati për çdo rast.

Gjithashtu në aktin e vlerësimit të KLD-së 2013–2014 ajo është vlerësuar maksimalisht. Për këtë arsye është propozuar shkallë shumë e lartë aftësie, 25 pikë.

Lidhur me “Efektivitetin dhe metodologjinë e vlerësimit”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me këtë aspekt, rezulton angazhimi maksimal i gjyqtarës së komanduar në drejtim të organizimit të punës për trajtimin e rasteve, rezulton angazhimi maksimal i gjyqtarës së komanduar për përshtatjen dhe ndjekjen e një metodologjie efektive në drejtim të organizimit të punës, si dhe rezultojnë aftësitë e saj krijuese për të sjellë dhe aplikuar risi në funksion të përmirësimit të punës, në drejtim të efijencës dhe profesionalizmit për trajtimin e ankesave apo materialeve përkatëse. Për pasojë, aftësitë e saj për këtë tregues janë vlerësuar shumë të larta duke u pikëzuar maksimalisht.

Pikëzim maksimal propozohet edhe për dy treguesit e tjerë “Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit”, “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit”. Dokumentat janë renditur në mënyrë që janë lehtësisht të shfrytëzueshme dhe pasqyrojnë të gjitha veprimet procedurale të kryera, ndërkohë që nuk rezulton mungesa e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes apo ato që i përkasin çështjeve të tjera. Për këtë arsye propozohet me pikët maksimale edhe për të dy këta tregues.

Përfundimisht për kriterin e dytë “Aftësitë organizative” propozimi është 100 pikë, “Shkëlqyeshëm”.

Për sa i përket kriterit të tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, “Etika në punë”, referuar burimeve të vlerësimit, të cilat veç atyre që kam relatuar janë edhe burimet arkivore të ish-KLD-së apo KLGJ-së, të dhënat për masat disiplinore,

raporti i ILDKPI-së i pasqyruar në vendimin e KPK-së, rezultatet e verifikimit të ankesave, etj.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit nuk kanë rezultuar të dhëna që mund të afektojnë lidhur me këtë kriter. Është propozuar shkallë shumë e lartë aftësie pasi gjyqtarja ka reflektuar shkallë të lartë angazhimi dhe përgjegjshmërie në funksion. Nuk ka të dhëna të cilat mund të flasin për sjellje ofensive, mungesë respekti, vetëpërbajtje, etj.

Për sa i përket integritetit, “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, nga të gjitha burimet e vlerësimit nuk ka të dhëna që afektojnë negativisht. Përmenden në projektraport edhe konkluzionet e KPK-së lidhur me verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Për këtë arsye, për shkak të prezumimit, propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, 40 pikë.

“Paanësia e gjyqtarit - Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”, edhe për këtë tregues propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi me 10 pikë.

Evidentohet kujdes i shtuar i gjyqtarës në mënyrën e trajtimit të rasteve dhe përdorimit të fjalëve në rastet kur janë evidentuar problematika që mund të fillonin në verifikimin e ankesave apo dhe një procedim disiplinor. Nga ana tjetër nuk ka rezultuar që të ketë paraqitur ndonjë kërkesë për heqje dorë nga një procedurë administrative apo të jetë përjashtuar nga procedurat administrative të trajtimit të ankesave dhe për këtë arsye është vlerësuar edhe për kriterin e fundit 15 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” propozohet niveli më i lartë i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, 100 pikë.

Për sa i përket “Aftësive profesionale dhe angazhimit profesional”, vlerësohet maksimalisht për “Komunikimin e qartë dhe transparent”, për “Respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” e cila merr vlerë akoma më të shtuar kur bëhet fjalë për verifikimin e trajtimit të ankesave ndaj gjyqtarëve, “Aftësisë për të bashkëpunuar” si dhe “Gatishmërisë dhe kontributit për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese”, në këtë rast ka qenë evidente që ajo veç detyrës funksionale njëkohësisht të ushtruar gjatë periudhës së vlerësimit ka marrë pjesë në grupe pune, në kuadër të caktimit nga struktura drejtuese, grupi i punës për hartimin e

skemës së vlerësimit të punës së inspektorit, ka marrë pjesë në përfaqësime gjyqësore, ka marrë pjesë në hartimin e projektvendimit të ish-KLD-së për instalimin e portalit të ankesave online, mundësuar me asistencën e Prezencës së OSBE-së, në përgatitjen e “Memo – Mbi procesin e verifikimit të ankesave në Inspektoratin e KLD-së”, datë 03.12.2013, në hartimin e planeve tematike të inspektimit dhe njëkohësisht ka kontribuar në përgatitjen e 6 inspektimeve tematike, gjithashtu ka propozime konkrete për përmirësimin e akteve dhe konkretisht ka paraqitur për mbledhjen e KLD-së rekomandimin për trajtimin e problematikës së hasur mbi verifikimin e informacioneve periodike të kryetarëve të gjykatave në kushtet e mungesës së një ankese të mirëfilltë.

Duke qenë se ka të dhëna që flasin për gatishmërinë dhe kontributin efektiv të saj për të kryer detyra të tjera veç atyre të trajtimit të ankesave, është propozuar pikëzimi me 5 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë” vlerësohet shumë e lartë, nisur edhe nga afatet e shkurtra të trajtimit të ankesave.

Lidhur me “Gatishmërinë për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, “Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues”, brenda dhe jashtë vendit janë në total 38, të tilla që sipas metodologjisë çojnë në pikëzimin me 20 pikë. Ka marrë pjesë edhe në trajnimin e gjyqtarëve. Ka të dhëna, ka qenë lehtësuese në aktivitetin trajnues me temë “Reforma në sistemin gjyqësor” (Problematika e procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe praktika e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në këtë drejtim. Vetëqeverisja, si dhe kompetencat e kryetarit të gjykatës dhe të kancelarit në administrimin, si figura drejtueses. Zbatimi i sistemit të vlerësimit profesional të gjyqtarëve), zhvilluar në datën 27 shkurt 2015. Për këtë arsye, duke qenë se ka të dhëna, i janë shtuar edhe dy pikë duke u pikëzuar me 5 pikë.

Lidhur me “Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë”, të cilat nuk varen nga funksioni, ka pasur gjithashtu të dhëna. Konkretisht ka qenë pjesëmarrëse në takimet e Këshillit Drejtues për të lehtësuar zbatimin e projektit “Mbështetje për efikasitetin e drejtësisë SEJ”, financuar nga BE dhe KE, me fokus përzgjedhjen e 10 gjyqtarëve pilot; njëkohësisht ka pjesëmarrje në takimet e misionit TAIEX lidhur me bashkëpunimin me ILDKPKI në luftën kundër

korupsionit, pjesë e detyrimeve që burojnë nga Dokumenti i Udhërrëfyesit të pesë prioritetëve për marrjen e statusit të vendit kandidati, të mbajtura në datat 17–18 qershor 2014.

Të gjitha këto angazhime, për shkak të natyrës së punës nuk lidhen ekskluzivisht me pozicionin e punës së gjyqtarit të komanduar dhe as përbëjnë detyra të tjera të caktuara nga organet drejtuese të ish–KLD–së, pavarësisht se përzgjedhja për angazhim në veprimtari ndërinstitucionale është bërë nga institucioni ku gjyqtarja ka qenë e komanduar dhe për këtë arsye i janë shtuar edhe dy pikë të tjera, duke u pikëzuar me 5 pikë.

Nuk ka asnjë publikim ligjor akademik – 0 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e fundit propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 95.

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është “Shkëlqyeshëm”. Pikët në total janë 395: 100 “Aftësia profesionale”, 100 “Aftësia organizative”, 100 “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe 95 “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua nga relatorja në lidhje me rastin në fjalë?

Nuk ka diskutime, atëherë vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013–2016, gjatë ushtrimit të detyrës së inspektore pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016 gjatë ushtrimit të detyrës së inspektore pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, duke e vlerësuar atë, si më poshtë:

- A. Aftësia profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësia organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësia personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 08.05.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projekt-raportit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...} {...} për periudhën e vlerësimit 2013 -2016 (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:52 dhe mbaroi në orën 13:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Rezarta Taushani, Gentiana Agushi dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL).**
- 5. Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Edmond Hoxhaj, BIRN.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektraportit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...} {...} për periudhën e vlerësimit 2013–2016 (relatore *znj. Irena Plaku*).

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës, shqyrtimi i projektraportit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...} {...} për periudhën e vlerësimit 2013–2016. Për më tej fjalën relatores *znj. Plaku*.

Irena Plaku: Faleminderit!

Në mënyrë të përmbledhur parashtroj projektraportin e vlerësimit për gjyqtarën {...}.

Procedura e vlerësimit ka filluar me vendimin nr. 81, datë 16.02.2023. Është kryer shorti. Janë administruar dosjet.

Në pjesën e parë të projektraportit janë pasqyruar burimet e vlerësimit dhe evidentimi i të dhënave që rezultojnë prej tyre. Konkretisht në grupin e parë të burimeve të vlerësimit janë aktet dhe dokumentet e përdorura në vlerësimin e aftësive profesionale nga organet e rivlerësimit të listuara si më poshtë:

1. Formulari i vetë deklaramentit të gjyqtarës; 2. Të dhënat e dosjes personale të gjyqtarës; 3. Të dhënat statistikore – ku rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016 gjyqtarja ka punuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë deri në datë 03.11.2013 dhe nga data 04.11.2013 e në vijim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Referuar të dhënave statistikore rezulton që në periudhën 04.11.2013–08.10.2016 (në fakt është deri në prill të 2016 ka ushtruar funksionin e gjyqtarës për shkak se ka marrë lejen e lindjes), ka gjykuar në Gjykatën Administrative 1462 çështje, nga të cilat 937 çështje administrative, 192 marrëdhënie pune dhe 334 çështje të tjera. Me palë kundërshtarë ka gjykuar rreth 1129 çështje.

Janë përshkruar në mënyrë të detajuar 5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet, më pas janë vendimet e administruara për shkak të ankesave ku nuk ka rezultuar që të jetë administruar vendim për shkak të ankesave; të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së, ku rezulton që gjatë periudhës trevjeçare të vlerësimit janë regjistruar 9 ankesa, 5 të vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 3 të vitit 2016. 4 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak me arsyetimin se 2 prej tyre (2 të vitit 2014) janë ankesa të përsëritura, 2 prej tyre (të vitit 2016) zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. 5 ankesa të tjera janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë: 3 ankesa të vitit 2014 verifikuar për zvarritje gjykimi, i janë regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik (janë vlerësuar tek aftësitë organizative të gjyqtarës); 1 ankesë e vitit 2015 verifikuar për zvarritje, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje (marrë në konsideratë tek kriteri i dytë i vlerësimit); 1 ankesë sugjeruar verifikim për shkelje etike, i është dërguar ILD-së, e cila pas verifikimit ka dhënë informacionin se kjo ankesë është arkivuar pas verifikimit të saj. Kjo është sqaruar në kriterin përkatës.

Pjesa e dytë e projektraportit ku pasqyrohet analiza e të dhënave në lidhje me katër kriteret e vlerësimit të aftësive të gjyqtarës.

Aftësitë profesionale të gjyqtarës, treguesi Njohuritë ligjore.

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja përpara përcaktimit të fakteve të çështjes, pasqyron procedurën e ndjekur nga gjykata dhe vendimet e marra në funksion të zbatimit të saj. Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron faktet e çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i identifikuar ato në pjesën më të madhe të vendimeve burim vlerësimi, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e faktit”. Faktet e çështjes në çdo rast janë paraqitur në mënyrë kronologjike, duke integruar në përmbajtjen e tyre, edhe provat e administruara mbi bazën e të cilave nga gjykata është vlerësuar se provohet...

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja identifikon dhe përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, pas paraqitjes së rrethanave procedurale, analizës së faktit dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, duke analizuar objektin dhe shkakun e padisë, si dhe përmes gjithë analizës së kuadrit ligjor mbi të cilin themelohet kërkimi.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se pas pasqyrimin të fakteve të çështjes dhe pretendimeve të palëve në gjykim, gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Administrative, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Janë cituar në mënyrë të detajuar të gjitha dispozitat të cilat janë cituar nga gjyqtarja në vendimet burim vlerësimi.

Gjithashtu është konstatuar përveç ligjeve të posaçme edhe citimi i nenit 42 të Kushtetutës, neni 6 të Konventës, etj.

Në tërësi, nga analiza e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të kuptueshme të fakteve të çështjes, proces të cilin gjyqtarja e arrin nëpërmjet analizës së integruar më vete dhe në tërësi të

provave, pavarësisht pretendimeve të palëve mbi rrethanat e faktit. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në përcaktimin e natyrës juridike të marrëdhënies objekt shqyrtimi, përcaktimi të cilin e bën në mënyrë të shprehur, duke e referuar si konkluzion të analizës së saj mbi objektin dhe shkakun ligjor të padisë. Edhe në vendimin penal të zgjedhur prej saj, gjyqtarja shfaq aftësi shumë të larta në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjit të zbatueshëm. Po kështu, rezultojnë aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktet objekt shqyrtimi, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit “Aftësia për të interpretuar ligjin”, nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në çdo rast, citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete, por edhe interpretimin literal apo sistematik të normave, interpretim i cili duke e përqsaur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, sjell si pasojë logjike konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Janë pasqyruar në mënyrë të detajuar normat të cilat janë analizuar nga ana e gjyqtarës në secilin burim vlerësimi si dhe në dispozitat konkrete të ligjeve të posaçme, të VKM-ve, etj.

Gjithashtu është konstatuar se në vendimet burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ndër të tjera zbaton dhe analizon parimet e përgjithshme të së drejtës, konkretisht parimet e procesit të rregullt ligjor, parimin procedural të barrës së provës, etj.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuar, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të zbatuar, referuar dhe kur është rasti për të analizuar aspektet të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht lidhur me elementin e barrës së provës, si dhe për të referuar parime të tjera procedurale dhe materiale, në mbështetje të interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme, si në aspektin procedural ashtu edhe në atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e gjyqtarës lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes. I njëjti kujdes tregohet edhe në të vetmin vendim penal të marrë në vlerësim ku gjyqtarja ndalet në analizën e të gjithë elementëve të veprave penale. Në disa nga çështjet burim vlerësimi, gjyqtarja ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ në mbështetje të argumenteve të saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë në këtë tregues, vlerësohet se aftësia e saj është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket nëntreguesit “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe

në vendimet gjyqësore përfundimtare, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në kllapa), duke u shoqëruar gjithmonë me dhënien e kuptimit në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre. Po ashtu, në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht si pasojë e referimit në ligje të posaçëm me karakter specifik, përdorimi i termave teknike është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose rezulton i qartë nga konteksti i arsytimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimin e fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Gjyqtarja ndër të tjera, në arsytimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsytimit të vendimit.

Në vendimet përfundimtare burim vlerësimi gjyqtarja pasqyron dhe merr në analizë në çdo rast elementët proceduralë si kompetenca, juridiksioni, trajtimin e kërkesave të palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor dhe vendimmarrjet prospektive të gjykatës lidhur me to, pavarësisht se nga përmbajtja e vendimit, jo në çdo rast këto elementë kanë qenë të diskutueshme nga palët apo rrethanat e çështjes. Në vendimet burim vlerësimi pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat merren në analizë nga gjyqtarja në mënyrë të specifike në pjesën arsyetuese të vendimit. Po kështu, në të gjitha vendimeve e analizuara, evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, por duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zbërthimin e dispozitave të cituara. Prezenca e këtyre elementëve, në disa raste në mënyrë tepër të detajuar, gjithsesi i jep

qartësi elementëve procedurale të gjykimit ose vendimit, dhe nuk cenon koncizitetin e tij.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit të shprehur, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime logjike nga njëra pjesë e vendimi tek tjetra, në shërbim të argumentimit të çështjeve të ngritura prej saj për zgjidhjen, apo zgjidhjen tërësorë të çështjes.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë lidhur me këtë tregues, vlerësoj se aftësia e saj është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet në çdo rast. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese arsytuese në nënndarje, të identifikuara më tituj duke orientuar qartë përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese – arsytuese të vendimit.

Pjesa hyrëse përmban të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupin gjykues dhe sekretaren gjyqësore, datën e shqyrtimit, prezencën ose mungesën e palëve, objektin e mosmarrëveshjes administrative apo akuzën në çështjen penale, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur. Gjithashtu në këtë pjesë, analizohet kryesisht nga gjykata juridiksioni, kompetenca lëndore dhe tokësore.

Pjesa përshkuese-arsytuese është e ndarë në disa pjesë: ndalet në paraqitjen e padisë nga pala paditëse, si dhe evidentimin e vendimmarrjeve të ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. për marrjen e masës së sigurimit të padisë, shtimin e palëve ndërgjyqëse pasive, apo ndryshimin/pakësimin e objekti të padisë, thirrjen e personave të tretë, etj; Faktit dhe rrethanat e provuara në gjykim. Në këtë pjesë gjyqtarja përshkruan dhe analizon faktet thelbësore të çështjes, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim së bashku me analizën e tyre, duke ndjekur kryesisht një rend kronologjik në paraqitjen e faktit, siç ka rezultuar e provuar; Pretendimet e palëve, pjesë në të cilën gjyqtarja parashtron në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e secilës

palë së bashku me argumentet e tyre; Kuadri ligjor dhe zgjidhja juridike e çështjes, në të cilën gjyqtarja fillimisht citon ligjin material e procedural që zbatohen në çështjen konkrete, duke i referuar dispozitat materiale administrative, civile dhe penale, por edhe ato të ligjit të posaçëm në të cilën të referon fakti juridik, merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke bërë interpretimin e tij, parapara aplikimit mbi faktet e çështjes. Në një pjesë të vendimeve burim vlerësimi, gjyqtarja ka ndjekur metodën IRAC, duke shtruar, menjëherë pas përshkrimit të analizës së fakteve procedurale dhe thelbësore të çështjes, pyetjet/çështjet ligjore të vlerësuara thelbësore, për zgjidhjen e çështjes konkrete, të cilat janë identifikuar qartë në vendimet gjyqësore.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarës dhe sekretarës gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim si dhe disponimin mbi shpenzimet gjyqësore.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij. Mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e mirëstrukturuar, gjithmonë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Kjo mënyrë e standardizuar e të shkruarit të vendimit gjyqësor, orienton lexuesin dhe i shërben kuptueshmërisë së logjikës juridike për atë që është konkluduar. Në përgjithësi konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike.

Pas analizimit të të dhënave lidhur me këtë tregues vlerësoj se aftësia e saj është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik” - Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i detajuar, i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin administrativ, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Rezulton se vendimet gjyqësore dominohen nga proces analitik dhe vlerësues në raport me atë përshkrues të fakteve dhe provave. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj edhe provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarës për provueshmërinë e fakteve konkrete. Gjyqtarja zhvillon analizën juridike për secilin kërkim të ngritur në kërkesëpadi (ose pasi ka parashtruar çështjet/pyetjet ligjore për diskutim), ku integron analizën e lidhjes shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, ligjit përkatës dhe mënyrën e aplikimit të tij në rrethanat konkrete.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u parashtruar në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsyetimit dhe më pas duke u marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë ose jo të tyre, në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimin konkret.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm, si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruarra për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Pas analizimit të të dhënave që rezultojnë për këtë tregues, vlerësoj se aftësia e saj është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Propozimi i vlerësimit për kriterin “Aftësia profesionale është 100 pikë, vlerësimi “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket kriterit të dytë “Aftësia organizative të gjyqtares” konkretisht për treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, nga burimet e vlerësimit nuk ka rezultuar asnjë nga dosjet që janë administruar (11 dosje dhe 3 vendimet të cilat janë zgjedhur nga ana e gjyqtares) që të kenë parashikuar afat ligjor. Ndërsa të dhënat statistikore nuk mundësojnë një vlerësim të tillë. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e saj është 15 pikë.

“Plotësimi i standardeve minimale”. Në këtë kriter janë marrë parasysh 11 çështje, si dhe 1 çështje referuar për vlerësim etik. Kohëzgjatja e secilit vendim burim vlerësimi për të cilin ka të dhëna duke e përshkruar afatin në ditë të shqyrtimit të tyre. Gjithashtu referuar metodologjisë së pikëzimit ka rezultuar se... respektimi i standardeve ka rezultuar në masën që nuk janë respektuar 28%, e cila pikëzohet me 3 pikë. Megjithatë, po të zbrisim vetëm një çështje e cila ka zgjatur tej standardit minimal. Përqindja po të heqim vetëm një nga çështjet rezulton me 21%, 1 pikë duke tejkalluar pikëzimin me 4 pikë. Pavarësisht se për 28 % të çështjeve të shqyrtuara (burime vlerësimi), rezulton tejkallim i standardit minimal kohor të pranuar prej 18 ditë, 1 muaj, 2 muaj dhe 1 çështje me 8 muaj, rezulton se ka qenë përgjithësisht pasojë e ecures procedurale të çështjes dhe në disa raste për shkak të mosformimit të trupit gjykues (mungesës së gjyqtares për arsye shëndetësore e provuar me raport shëndetësor), mosnjohimit rregullisht të palëve ndërgjyqëse për shkak të problemeve të shërbimit postar apo adresave të pasakta.

Nga ana tjetër në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtarja ka përfunduar në total për një periudhë prej thajse 2 vite e 6 muaj periudhë vlerësimi (nga data 04.11.2013 deri në datën 12.04.2016), 1462 çështje gjithsej, nga të cilat 937 çështje administrative, 192 marrëdhënie pune. Pra përgjatë kësaj periudhe ka gjykuar 1129 çështje me palë kundërshtare, mesatarisht rreth 451.6 çështje themeli në vit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 150 çështje themeli në vit, referuar

vendimit 261/2 të ish-KLD-së, duke qenë mbi standardin minimal të shqyrtimit të çështjeve në masën 201 %, ngarkesë në punë që e justifikon pikëzimin maksimal.

Pasi kemi marrë në analizë këto të dhëna, vlerësoj se konkretisht shkaqet që ka tejkaluara pra nuk është respektuar standardi minimal, të cilat u relatuan më sipër si dhe faktin se gjyqtarja e ka tejkaluara standardin minimal të ngarkesës në punë në masën 201%, vlerësoj pikëzimin e saj maksimal për këtë tregues me 5 pikë.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”. Edhe këtu janë analizuar të gjitha çështjet burim vlerësimi duke i ndarë në kategori.

duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të dy kategoritë për të cilat ka të dhëna, me afatin 87-ditor të pranuar si një standard minimal për një gjykim administrativ, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve, shkallë aftësie e cila sipas metodologjisë përkon me pikëzimin me 3 pikë. Por duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, vetëm për një kategori, tejkalohe vetëm me 25 ditë, ku ndikon ndjeshëm vetëm nga 1 çështje e cila ka zgjatur për rreth 314 ditë, dhe për të cilën nuk ka të dhëna për kohën e shortimit si dhe shkaqet që kanë ndikuar në zgjatjen e këtij gjykimi, duke qenë se është vendimi i zgjedhur nga gjyqtarja, si dhe nuk është administruar dosja.

Mbështetur në të njëjtën analizë si treguesi më sipër, duke e konsideruar afatin 87-ditor si standard minimal, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më gjatë se standardi për gjysmën e kategorive. Mbështetur në të njëjtën analizë si treguesi më sipër, konkretisht duke marrë në konsideratë shkaqet e shtyrjeve dhe të zgjatjeve të gjykimeve, të cilat kanë qenë kryesisht për shkaqe procedurale, por edhe të mungesës së njoftimeve të palëve, kompleksitetit të çështjeve, ku është dashur marrja edhe e provës me ekspert, apo thirrje të personave të tretë, ngarkesën e gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit, që siç relatua më sipër është 1486 çështje për një periudhë prej 2.5 muaj. Edhe për këtë kriter është vlerësuar pikëzimi i saj maksimal me 5 pikë. Referuar sa më sipër, vlerësoj se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje duhet të konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për gjykimin

administrativ, për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

“Rendimenti i përfundimit të çështjeve” – është marrë në konsideratë rendimenti i hartuar në raportin analitik të vlerësimit lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve, ku ka rezultuar me 95%. Gjithashtu është bërë edhe një rivlerësim edhe një herë të rendimentit të gjyqtarës referuar të dhënave statistikore të cilat kanë rezultuar nga vërtetimet e paraqitura nga gjykata përkatëse, ku pas analizës është vlerësuar me 97.9 %, përqindje kjo që sipas metodologjisë së pikëzimit, pikëzohet me 8 pikë. Edhe përqindja 95% i njëjti pikëzim rezultonte. Duke iu referuar raportit të KLGJ-së si dhe rillogaritjes ku ka rezultuar rendimenti 97.9 %, përqindje e cila referuar metodologjisë së pikëzimit, pikëzohet me 8 pikë, pasur parasysh se Gjykata Administrative ka filluar punë efektivisht në datën 04.11.2013 dhe në muajin prill gjyqtarja është larguar me leje lindje, faktin se në çdo vit ajo ka tejkaluar standardin minimal me 201% në vit, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet maksimalisht, me 10 pikë.

Sa i përket “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit” është marrë në analizë koha mesatare e arsyetimit të secilit vendim burim vlerësimi si dhe një vendim i cili është referuar nga Inspektorati për shkak të ankesës. Referuar dy kategorive të çështjeve, konkretisht (i) për kategorinë “çështje administrative me palë kundërshtare”, koha mesatare është 7.4 ditë, ndërsa ii) për kategorinë “marrëdhënie pune”, është 7.3 ditë, duke e tejkaluar afatin 7-ditor me 0.4 dhe 0.3 ditë.

Referuar sa më sipër për këtë kriter është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë, duke e konsideruar kohën mesatare të arsyetimit të vendimit më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural, pasur parasysh faktin se ka një tejkalim shumë të papërfillshëm i cili nuk kalon asnjë ditë.

Sa i përket treguesit “Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore”, janë analizuar shkaqet e shtyrjes dhe seancat produktive dhe jo produktive, janë analizuar secila. Në projektraport janë të detajuara të dhënat për secilën dosje më vete.

Sa i përket numrit të seancave gjyqësore rezulton se: (i) për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare” numri mesatar i seancave është 3.6 seanca; (ii) për “marrëdhënie pune” është 1.6 seanca. Numri mesatar i seancave

gjqësore, duke iu referuar 12 çështjeve të vëzhguara (konkretisht 11 çështjet e përzgjedhura me short dhe 1 çështje e referuar për shkak të ankesave), rezulton të jetë 3.1 seanca. Ndërsa po të heqin nga ky numër, seancat e shtyra për të shpallur vendimin, rezulton se numri mesatar i seancave për 12 çështjet është 2.6 seanca.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3.1 seanca për kategorinë e çështjeve me palë kundërshtare, numër i cili zbret në 2.6 seanca po të zbresim seancat e shtyrë për të shpallur vendimin në referim të nenit 42/2 të ligjit nr.49/2012, si dhe faktit se shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është shumë e lartë, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta, evidentuar në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në veprimet përgatitore, seancat përgatitore, duke respektuar në çdo rast afatet e përcaktuar në ligj. Aftësia e saj është shumë e lartë duke e pikëzuar me 20 pikë.

Sa i përket treguesit “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” - Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi; ka një strukturë të vetën në të cilën administrohen dokumentacioni i dosjes dhe e bëjnë të aksesueshme.

Referuar sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 5 pikë.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” - Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe nuk konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Për kriterin “Aftësia organizative e gjyqtares”, propozohet vlerësimi i saj me 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” – edhe për këtë tregues niveli i vlerësimit/pikëzimit është vlerësuar në tërësi 100 pikë, duke e vlerësuar “Shkëlqyeshëm”.

Për sa i përket “Angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion”, janë verifikuar ankesat e paraqitura nga ILD-ja. Gjithashtu është verifikuar edhe ankesa e cila është referuar/sugjeruar për shkelje etike pranë ILD-së e cila me vendimin e datës 22.11.2022 ka vendosur arkivimin e saj. Gjithashtu nga materialet e verifikimit të kësaj ankese, megjithëse është arkivuar për shkak të afateve të parashkrimit, nga përmbajtja e vendimit konstatohet se është bërë verifikimi përkatës dhe nuk ka rezultuar që të ketë shkelje, të provohet shkelja e pretenduar nga pala e cila ka paraqitur ankesë.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë, duke e pikëzuar me 35 pikë.

“Integriteti i gjyqtares” – si burim është marrë edhe vendimi i KPK-së, konkluzionet e arritura prej tij. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integriteti si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin.

Referuar sa më sipër edhe për këtë tregues është vlerësuar aftësia e saj shumë e lartë, duke u pikëzuar me 40 pikë.

Sa i përket treguesin “Paanësia e gjyqtares”, “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton

se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuuese, duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares” – Nga burimet e vlerësimit nuk rezulton nga dosjet të cilat janë administruar që të jetë pranuar ndonjë kërkesë për përjashtimin e saj. Ndërsa nga të dhënat statistikore nuk kemi të dhëna sepse nuk janë në atë formë të tillë.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është “i pakonsiderueshëm” duke e pikëzuar me 15 pikë.

Siç e theksova më sipër, propozimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë, vlerësimi “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket kriterit “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, sa i përket treguesit “Komunikimi i qartë dhe transparent”, në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në përpilimin e akteve procedurale.

Referuar sa më sipër vlerësohet se aftësia e saj është shumë e lartë duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket “Respektimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, edhe për këtë tregues nuk ka të dhëna të cilat mund të rezultojnë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale.

Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e saj është shumë “e lartë” duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit, vlerësoj se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën

gjqësore”, edhe për këtë tregues nuk ka të dhëna. Sa më sipër prezumohet se aftësia e saj është shumë e lartë duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, konkretisht “Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues”, referuar të dhënave burim vlerësimi ka rezultuar ...vërtetimit të paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës se gjyqtarja ka marrë pjesë në disa aktivitete trajnuese, ka rezultuar se ka marrë pjesë në 17 aktivitete të zhvilluara për 30 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120. Për sa më sipër, për këtë tregues duhet të vlerësohet 20 pikë.

“Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatë”, ka rezultuar se gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit është angazhuar si lehtësuese pranë Shkollës së Magjistraturës. Për këtë arsye, duke qenë se ka të dhëna për këtë tregues, nga 3 pikë duhet të pikëzohet me 5 pikë (për sa kohë ka të dhëna).

Për sa i përket angazhimit të gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale, referuar burimeve të vlerësimit, konkretisht në dosjen personale të gjyqtarës, rezulton se është angazhuar si eksperte në Projektin e OSCE-së në Shqipëri në departamentin e draftimit. Në dosje ndodhet edhe kontrata e lidhur nga ana e gjyqtarës që synonte në hartimin e rasteve gjyqësore/kazuseve dhe pjesëmarrje në trupa gjykues të gjyqeve imituese të organizuara me/për shkollën e Avokatisë në Shqipëri.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarës, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë. Duke qenë se rezultojnë të dhëna propozohet vlerësimi i saj me 5 pikë.

“Publikimet ligjore” – në dosjen personale të gjyqtarës rezulton se gjyqtarja ka një botim por i përket vitit 2007, konkretisht në Revistën Juridike. Por duke qenë se ky botim është jashtë periudhës së vlerësimit dhe nuk rezultojnë të dhëna për publikime gjatë periudhës së vlerësimit, propozohet pikëzimi i saj me 0 pikë.

Kështu propozimi për kriterin e fundit është 95 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për katër kriteret është:

Për kriterin e parë 100 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Për kriterin e dytë “Aftësitë organizative të gjyqtares”, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Për kriterin e katërt, pikëzimi propozohet me 95 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është 395 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u relatua nga zonja Plaku për rastin në fjalë.

Meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013–2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 08.05.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projekt-opinionit “Mbi kandidatin që ka aplikuar për t’u komanduar në Shkollën e Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:52 dhe mbaroi në orën 13:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL).*
5. *Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projekt-opinionit “Mbi kandidatin që ka aplikuar për t’u komanduar në Shkollën e Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projekt-opinionit “Mbi kandidatin që ka aplikuar për t’u komanduar në Shkollën e Magjistraturës”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Po prezantoj projektvendimet dhe opinionin përkatës që i referohet kërkesës së paraqitur nga kandidatja znj. {...} për procedurat e hapjes së vendit të komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës.

Pa humbur kohë po filloj me leximin e projekt-opinionit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 86, shkronja “d” dhe nenin 264 të ligjit nr.115/2016, në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016, si dhe në kërkesën e Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 40, datë 27.01.2023 ka vendosur: “Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Shkollën e Magjistraturës. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm”.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim ishte përcaktuar data 13 shkurt.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur një kërkesë e vetme.

Me aktin nr. 1190, datë 10.02.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës znj. {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Znj. {...} ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në Shkollën e Magjistraturës për pozicionin “Pedagog i brendshëm, me drejtim formimin vazhdues”.

Në vendimin nr. 40, datë 27.01.2023 të Këshillit, konkretisht në Kreun II të tij, është përcaktuar edhe procedura që do të ndiqet nga Këshilli. Për vlerësimin e kushteve të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit. Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendosë përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të komandimit. Emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies, së bashku me Opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionin e paraqitur prej tyre, i përcillen menjëherë për vlerësim Shkollës së Magjistraturës.

Vlerësimi i kriterit të komandimit të mësimdhënies dhe i kriterëve shtesë për pozicionin vakant si më sipër, bëhet nga Shkolla e Magjistraturës, në zbatim të Rregullores së Brendshme të miratuar prej saj.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 8 të Kreut II, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell Shkollës së Magjistraturës emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies, së bashku me opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionin e paraqitur prej tyre, i përcillen menjëherë për vlerësim Shkollës së Magjistraturës.

Në pikën 10 dhe 11 të këtij Kreu, parashikohet se: “Përzgjedhja e kandidatit për vendin vakant në pozicionin e pedagogut të brendshëm, bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës. Brenda dy javëve nga marrja e vendimit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe të kërkesës për komandim nga Shkolla, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin e gjyqtarit të përzgjedhur, në pozicionin e pedagogut të brendshëm”.

Vlerësimi i Komisionit –

Në respektim të procedurës që duhet të ndiqet sipas vendimit nr. 40, datë 27.01.2023 të Këshillit në fazën e parë, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin.

Në këto rrethana Komisioni i Zhvillimit të Karrierës harton projekt-opinionin për kandidaten përkatëse. Në përgatitjen e këtij opinionin për këtë kandidate, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, verifikon ekzistencën ose jo të ndonjë prej kushteve ndaluese si dhe vlerëson cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtari që ka paraqitur kërkesën për komandim, si edhe vlerëson kriteret e tjera të komandimit përveç mësimdhënies.

Në lidhje me kushtet ndaluese të komandimit –

Kushtet e komandimit përcaktohen në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar. Po ashtu ato janë përcaktuar në pikën 3, Kreu II të vendimit të Këshillit nr. 40, datë

27.01.2023. Kushtet nuk po i përmend sepse janë të diskutuara në momentin që ne kemi shpallur vendin për komandim në Shkollën e Magjistraturës.

Lidhur me kushtet e komandimit sipas shkronjave “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 3, të vendimit të sipërpërmendur, sipas informacionit të marrë, më datë 17.02.2023, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në të dhënat e dosjes personale të kandidatit, rezulton se:

Zonja {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës më datë 12.07.2010. Njëkohësisht ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014.

Me dekret nr. 8353, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekret nr. 9235, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë këtë detyrë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është mbi 9 vite.

Zonja {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi

Në këto kushte, për këtë gjyqtare, nuk ekziston asnjë kusht ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës –

Sa i përket cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidatja ushtron funksionin, nga raportimet periodike dhe informacioni e mendimi i marrë nga zëvendëskryetari i gjykatës respektive, rezulton se (Pra është marrë mendimi i zv.kryetarit të Rrethit Gjyqësor Durrës dhe ai ka parashtruar këtë informacion të kërkuar: “... Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, aktualisht gjykojnë 8 (tetë) gjyqtarë, të cilët sipas urdhrit nr. {...} prot., datë 24.05.2021 vijoje duke gjykuar në një seksion të vetëm. Nga statistikat e vitit 2022 rezultojnë se janë gjykuar 7166 çështje në total, duke u përballuar kjo ngarkesë nga vetëm 6-7 gjyqtarë efektiv. Gjyqtarja {...}, nga muaji korrik 2021–shtator 2022 ka qenë me leje lindjeje. Aktualisht gjyqtarja ka në shqyrtim 390 çështje në proces gjykimi.

Është fakt i ditur tashmë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është konsideruar si një nga gjykatat në krizë, sa i përket numrit të çështjeve që paraqiten në raport me numrin e gjyqtarëve efektiv. Nga ana e zëvendëskryetarit të Gjykatës gjatë vitit 2022 është mbajtur korrespondencë me KLGJ-në, me qëllim gjetjen e mekanizmit të duhur për shtimin e gjyqtarëve në këtë gjykatë.

Me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor vendosi që për Gjykatën e Durrësit të hapen dy transferime të përkohshme dhe katër me lëvizje paralele. Po ashtu, së shpejti edhe Gjykata e Kavajës pritet të bashkohet me Gjykatën e Durrësit. Pra është informacion i marrë përpara sesa të ndodhemi në këto situata që kanë ndryshuar edhe për shkak të implementimit të hartës së re gjyqësore.

Në cilësinë e zëvendëskryetarit të Gjykatës, vlerësoj se gjyqtarja znj. ({...}) i ka aftësitë e duhura për të qenë pjesë e stafit të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, si pedagogje e brendshme. Por, vlerësoj se momentalisht largimi i gjyqtarës do të sillte efekt negativ për gjykatën, nisur nga ngarkesa e madhe që po përballohet dhe mungesa e gjyqtarëve.

Së fundmi, sjell në vëmendje se zëvendëskryetari i Gjykatës disa ditë më parë ka dhënë edhe një opinion tjetër në lidhje me një gjyqtare tjetër të kësaj gjykate për transferim, por që dallimi në këtë rast duhet bërë tek qëllimi, i cili në fund të ditës mbetet evadimi i çështjeve dhe kthimin e situatës në normalitet të gjykatave.

Këshilli ka ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar situatën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, si lëvizja paralele dhe transferimi i përkohshëm (vendimet nr.21–24 dhe 31–32 datë 18.01.2023). Është për tu vlerësuar ngarkesa aktuale e çështjeve që ka kjo gjykatë në raport me numrin aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë kësaj gjykate. Në analizën e bërë nga Këshilli lidhur me mekanizmat për përmirësimin e situatës rezultonte se 3035 dosje janë në shqyrtim aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, pra rreth 380 dosje/gjyqtar. Kjo situatë vlerësohet përballë opinionit të përcjellë nga zëvendëskryetari i gjykatës respektive për këtë çështje.

Kriteret e komandimit përveç atij specifik të mësimdhënies –

Në pikën Kreun II, pika 8 të vendimit 40/2023, është parashikuar se: “Këshilli i

Lartë Gjyqësor i përcjell Shkollës së Magjistraturës emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies.

Kriteret e komandimit për pozicionin “Pedagog i brendshëm”, janë (i referohemi kriterëve ligjore):

a) Kandidati duhet të ketë eksperiencë pune mbi pesëmbëdhjetë vjet si jurist, gjyqtar, prokuror, avokat dhe eksperiencë mësimdhënie si pedagog i brendshëm në sistemin universitar ose pedagog i jashtëm ose i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, mbi dhjetë vjet; ose

b) Kandidati, që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, duhet të ketë eksperiencë mbi dhjetë vjet si gjyqtar dhe eksperiencë mësimdhënie universitare në lëndët kryesore ose në Shkollën e Magjistraturës mbi pesë vjet.

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e pedagogut të brendshëm janë përcaktuar në nenin 264 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në Aneksin 11 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, ku parashikohet eksperiencia mbi 10 vjet (i referohemi eksperiencës në funksionet ose detyrën e gjyqtarit).

Nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, rezulton se znj. {...} është caktuar përkohësisht në detyrë në datën 21.10.2013 dhe duke llogaritur edhe këtë afat, pra vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës deri në momentin që është paraqitur kërkesa e saj, ajo ka pasur një vjetërsi në detyrë 9 vite e 3 muaj.

Lidhur me kriteret e tjera specifike, rezulton se është Gjyqtar pranë Gjykatës së Shkollës së Parë; ka kaluar Vetting-un; ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës; është në proces vlerësimi pranë Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ne kemi bërë propozimin tonë duke iu referuar dy çështjeve: i) çështja e parë lidhet me funksionalitetin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që referuar rrethanave që ne kemi ndërhyrë me ato instrumentat/mekanizmat tona, por edhe bërja e ditur nga kryetari në detyrë i Gjykatës së Shkollës së Parë Durrës që nëse do të largohet kjo gjyqtare, gjykatës do t’i priset funksionaliteti për shkak të ngarkesës së madhe në punë që kanë ato gjyqtarë dhe, ii) çështja e dytë që është më specifike i referohet nenit

264 të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i cili pra në nenin 264 ka paraqitur një kriter ligjor specifik sipas të cilit përvoja në detyrë e një gjyqtari i cili duhet të bëhet pjesë nëpërmjet skemës së komandimit si pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës duhet të jetë mbi 10 vjet përvojë si gjyqtar në detyrë.

Ndodhur përpara këtyre dy situatave/çështjeve, ne si Komision kemi bërë propozimin përkatës, duke menduar që kandidatja e vetme që ka paraqitur kërkesën e saj nuk plotëson këto dy kritere ligjore, dhe për këtë arsye ne i propozojmë Këshillit që të deklarojmë (pra të vendosim bashkërisht) përjashtimin e kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës. Në alternativë nëse ky propozim ynë nuk pranohet, është alternativa e dytë: T'i dërgohet Shkollës së Magjistraturës emri i znj. {...}, e cila ka aplikuar për t'u komanduar, në pozicionin "Pedagog i brendshëm" në Shkollën e Magjistraturës, si dhe praktikën dokumentare të paraqitur nga ana e saj (bashkëngjitur kërkesës së bërë nga zonja {...}).

Pra qëndrimi ynë si Komision është që nuk plotësohen këto dy çështje/kritere ligjore dhe propozojmë përpara Këshillit kërkesën për t'u miratuar në Këshill, kërkesë e cila ka të bëjë me përjashtimin e zonjës {...} nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme e Shkollës së Magjistraturës për shkak të mosplotësimit të kriterit të vjetërsisë mbi 10 vjet eksperiencë pune si gjyqtare në Gjykatën e Shkollës së Parë Durrës.

Ndërsa nëse nuk do merret në konsideratë ky propozim pastaj kemi bërë edhe projektvendimin e dytë alternativ që është: T'i dërgohet Shkollës së Magjistraturës emri i znj. {...}, për të vijuar më tej ajo procedurën e përzgjedhjes.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u parashtrua.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime nga anëtarët prezent në mbledhje për çfarë u relatua nga z. Kurushi, po hedhim në votim propozimin e z. Kurushi në lidhje me projektvendimin përkatës për përjashtimin e kandidates znj. {...} nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro, duke mbështetur argumentimin që gjyqtarja/kandidate për komandim nuk plotëson kriterin 10-vjeçar të eksperiencës në punë si gjyqtare.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përjashtimin e kandidates znj. {...} nga procedurat e kandidimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përjashtimin e kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës për shkak të mosplotësimit të kriterit të vjetërsisë mbi 10 vjet.

2. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 08.05.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi deklarin e përfundimit të statusit të Magjistratit për z. {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij”, (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:52 dhe mbaroi në orën 13:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Rezarta Taushani, Gentiana Agushi dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL).**
- 5. Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Edmond Hoxhaj, BIRN.**

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi deklarin e përfundimit të statusit të Magjistratit për z. {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij”, (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Kalojmë në pikën 8 të rendit të ditës që është: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi deklarin e përfundimit të statusit të Magjistratit për z. {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij”. Për më tej fjalën ia jap relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Pa humbur kohë po fillojmë me relacionin e radhës.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 11.04.2023 është depozituar një kërkesë e protokolluar me nr.{...}prot., nga gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Tiranë, z. {...}, nëpërmjet të cilës ai ka parashtruar heqjen dorë nga statusi i magjistratit.

Referuar të dhënave të marra pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative rezulton se: {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 27.06.1985 (sistemi pa shkëputje nga puna). Me vendim nr. 4, datë 10.11.1997 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i propozohet Presidentit të Republikës për t'u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 25 (njëzetë e pesë) vite. Zoti {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Në kërkesën e tij, gjyqtari Z. {...} ka parashtruar se: “ ... bazuar në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ju paraqes kërkesën time për heqje dorë nga statusi i magjistratit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar shqyrtimin e kësaj kërkesë nga ana juaj...”.

Nga informacioni i marrë në rrugë elektronike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datë 07.06.2022 ka rezultuar se: “Z.{...} ka aktualisht 253 çështje në gjykim”.

Ndërsa sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Shërbimeve juridike, z. {...} nuk është caktuar si anëtar i ndonjë trupi gjykues pas kërkesave të përcjella nga gjykatat për caktim gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë.

Propozimi

Referuar nenit 65 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se: “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.

Instituti i dorëheqjes është një akt vullnetar dhe nuk mund të jetë i kufizuar në kohë. Ai bazohet në vullnetin e lirë të magjistratit për të ndërprerë në çdo kohë vijimin

e detyrës dhe për rrjedhim kontrata e shërbimit publik për këtë shkak përfundon. Zoti {...} ka shprehur dëshirën e tij për tu dorëhequr nga funksioni i magjistratit duke qartësuar dhe siguruar vullnetin përpara institucionit si edhe ka kërkuar deklarin nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor të mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes.

Neni 65 i ligjit të sipërcituar, ka parashikuar dorëheqjen si shkak për përfundimin e statusit të magjistratit duke dhënë efekte në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli merr deklarin e dorëheqjes me shkrim të

Një shkak i tillë i mbarimit të statusit të magjistratit është trajtuar edhe me Vendimin nr. 34 datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese e cila në pikën 62 dhe 63 të tij shprehet se: "... 62) Jurisprudenca kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se mbarimi përpara afatit i mandatit të gjyqtarit sigurisht që mund të ndodhë dhe ky është një moment që njihet në praktikën kushtetuese dhe ligjore, por vetëm nëse vërtetohen ato raste, të cilat nuk kanë të bëjnë me mbarimin natyrshëm dhe në rrugën normale të tij, siç mund të jenë dorëheqja, arritja e moshës së pensionit, dënimi me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, etj. [...].

Për sa më lart, relatori i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të miratojë dorëheqjen e z. {...}, si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendosë:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.05.2023.

Bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi përkatës.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u parashtrua.

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, kalojmë në votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.05.2023.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës janë shqyrtuar të gjitha pikat e saj. Mbledhjen e deklarohet të mbyllur, duke ju uruar fundjavë të mbarë. Gjithashtu dhe gëzuar Ditën e Drejtësisë.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

59